



CRIMSON FINANCE FUND

CRIMSON FINANCE FUND ALBANIA

Raporti Jo-Financiar

Crimson Financial Fund Albania (CFFA) është një institucion financiar jo-bankë i themeluar në Tetor të vitit 2015 si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar nga katër partnerë/ortakë:

- Fondacioni Shqiptar-Amerikan i Zhvillimit (AADF)
- Crimson Capital corp.
- NORFUND
- Bashkia e Tiranës

Misioni i CFFA është të rrisë aksesin në tregun financiar për NMVM (ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme), të mbështesë projektet e tyre dhe të ndërtojë një mjedis të qëndrueshëm ekonomik.

Vizioni i CFFA është të mbështesë NMVM, Sipërmarrësit dhe Inovatorët, bizneset dhe sektorët e aktivitetit si Prodhimi, Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit (TIK), Efiçensa në Energji, Bujqësia dhe Tregtia me shumicë dhe pakicë, duke promovuar rritjen e qëndrueshme.

Ortakët e CFFA-së kanë investuar fillimisht 400,000 EUR në kapital të nënshkruar (100,000 EUR secili), dhe akorduar 1,959,000 EUR kredi të varur, të pasiguruar. Në shkurt të vitit 2020, ortakët kanë vendosur të konvertojnë 50% të kredisë së tyre drejt CFFA-së, në kapital të nënshkruar.

Përmes ofertës së tij të produkteve financiare, CFFA synon:

- *Të financojë në mënyrë inovative NMVM duke mbushur boshllëqet në treg dhe duke përdorur financimin e faturave të tyre (faktoring) dhe qiradhënien financiare*
- *Rritjen e shitjeve, përfitueshmërisë, eksporteve, zëvendësimin e importeve me produkte vendase, kapitalit neto (fitimit të pashpërndara) dhe konkurrencën në treg*
- *Ruajtjen dhe krijimin e vendve të reja të punës, dhe rritjen e të ardhurave - përfshirë vendet e punës në zonat rurale si edhe vendet e punës së kualifikuar*
- *Mbështetjen e fermerëve dhe furnizuesve të tjerë të vegjël, femrave dhe sipërmarrësve inovatorë.*
- *Rritjen e prodhimit vendas*
- *Përmirësimi i cilësisë, konkurrencës dhe stabilitetit të kompanive, produkteve, shërbimeve dhe zinxhirëve të vlerës.*

Oferta jonë

Oferta e CFFA-së përfshinë tre aspekte të aktivitetit të biznesit:

- Nevoja për **asete** (pajisje dhe makineri) - e mbuluar nëpërmjet produktit të Qirasë Financiare
- Nevoja për **likuiditet** (kapital qarkullues ose investime) – e mbuluar me anë të Faktoring-ut të Drejtpërdrejtë dhe “Sale/Leaseback” (Qiraja financiare e Anasjelltë)
- Nevoja për **inventar** - e mbuluar me anë të Faktoring-ut të anasjelltë

Më konkretisht, produktet financiare aktuale të CFFA janë si më poshtë:

Qiraja Financiare (Leasing) - Përmes qirasë financiare CFFA targeton sektorë me kontribut të lartë në zhvillimin ekonomik si prodhimi, energjia, transporti, bujqësia, turizmi etj., duke financuar nevojat e tyre për asete, deri në fazën e konsolidimit të aktivitetit të tyre dhe më gjërë.

Sale-Leaseback – Ndermarrjet e vogla dhe të mesme janë shumë dinamike, dhe shpesh i duhet të përdorin paratë të cilat i kanë investuara në asete. Për të fituar qasje në kapital qarkullues pa rritur borxhin e tyre, CFFA ofron mundësinë për të blerë asetet e kompanisë pa "shqetësuar" procesin e punës së biznesit.

Faktoring i drejtpërdrejtë - Mungesa e likuiditetit të mjaftueshëm shpesh është pengesë për të mbuluar kostot operative, pagesen e furnitorëve ose shfrytëzimin e mundësive të reja për tu

zhvilluar. Shpesh NMVM duhet të presin deri në 180 ditë që faturat e tyre të shitjes të shlyen. Për të zgjidhur këtë problem të parash në kohë, CFFA financon faturat e shitjeve deri në 180 ditë.

Faktoring i anasjelltë - Kryesisht i përdorur në sektorin e Tregtisë me shumicë dhe pakicë, Ndërtim dhe Prodhim, Faktoring-u i anasjelltë është financimi i faturave të blerjes. Kështu, NMVM shpesh herë duhet të rrisin nivelin e tyre të inventarit/lëndëve të para në mënyrë që të shfrytëzojnë mundësi të reja rritjeje. Bankat dhe institucionet e tjera financiare shpesh herë propozojnë financime me afate maturimi +12 muaj për të mbuluar këto nevoja, ndërkohë që cikli i shitjeve të NMVM rrallë herë i kalon 180 ditë.

Produktet financiare të CFFA synojnë ekskluzivisht ndërmarrjet (duke mos përfshirë familjet dhe individët). Financimet disbursohen në monedhat Lekë dhe euro. Duke marrë parasysh grupin e synuar të klientëve të CFFA-së, si dhe strukturën e kapitalit të tij, shuma e financimit varion nga 5.000 EUR deri në 100,000 EUR (dhe ekuivalente në ALL), dhe shuma mesatare e financimit ka një vlerë rreth 25,000 EUR.

1. Burimet njerëzore dhe autoritetet

Aktiviteti kryesor, Organizimi, Drejtimi & Kontrolli dhe Kodi i Etikës së Institucionit

Informacion i përgjithshëm

Crimson Finance Fund Albania shpk është një institucion financiar jo-banke i regjistruar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit me datë 07/01/2015 me NIPT L51307031A, dhe i licensuar nga Banka e Shqipërisë me License Nr. 34 datë 02/10/2015. Ai është një institucion i krijuar me kontributin e barabartë të katër ortakëve: Bashkia e Tiranës, Fondi Shqiptaro-Amerikan i Zhvillimit, Qeveria Norvegjeze (Norfund), dhe Crimson Capital corp.

CFFA ushtron veprimtarinë sipas Rregullores Nr. 1, datë 17/01/2013 “Për licensimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka” të Bankës së Shqipërisë, Neni 5, nepermjet ofrimit të faktoring-ut, urdher-blerjes (purchase order finance), qirase financiare, garanci, konsulence, ndërmjetesim si edhe shërbime të tjera financiare ndihmëse, asistencë teknike dhe trajnim për tregtarët, fermerët dhe ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Shqipëri.


Institucioni ka një dege të vetme. Selia ndodhet në rrugën “Bardhok Biba”, godina e vjetër, hyrja 1, kati 2, Tiranë.

Kapitali themeltar i regjistruar ne QKB

Kapitali i nenshkruar i Shoqerise eshte 55,000,000 Leke (31 Dhjetor 2019), i detajuar si me poshte:

Ortaku	Kuota	% e zoteruar
AADF	13,750,000	25
Municipality	13,750,000	25
Norfund	13,750,000	25
Crimson	13,750,000	25
Total	55,000,000	100

Informacion mbi strukturen e organizimit dhe administrimit



Organigrama e mësipërme paraqet rolet kryesore të Crimson Finance Fund Albania. Kompania drejtohet nga bordi drejtues (4 anëtarë) dhe Drejtori Ekzekutiv. Roli i auditimit të brendshëm është i mbuluar nga audituesi i brendshëm i AADF-së. Suporti IT dhe shërbimet juridike janë shërbime të jashtme. Departamenti i Financës dhe Administratës përbëhet nga menaxheri, një specialiste financiare dhe një asistente financiare. Departamenti i kredisë përbëhet nga dy oficerë kredie dhe një oficer operacional. Që nga prilli i vitit 2020, CFFA ka 5 punonjës me kohë të plotë dhe 3 punonjës me kohë të pjesshme (oficer operacional, asistente finance dhe një sanitare).

Bordi Drejtues

Bordi i Drejtoreve të Shoqërisë përbëhet nga 4 anëtarë të emeruar nga Ortaket. Secili anëtar i Bordit përfaqëson një partner të CFFA dhe ka një mandatë 3 vjeçar nga data e emerimit. Anëtarët janë:

1. Aleksander Sarapuli – Përfaqësues i Fondacionit Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim
2. Jonida Halili – Përfaqësuese e Bashkisë Tiranë
3. Kujartan Stigen – Përfaqësues i Norfund
4. Michael Gold – Përfaqësues i Crimson Capital Corp

Bordi i Drejtoreve si rregull mbledhet 4 herë në vit për të diskutuar, sugjeruar dhe marrë vendime për çështje të ndryshme. Përgjithësisht trajtohet një pamje e përgjithshme e shoqërisë, raportit të punës së biznesit, buxhetit, strategjitë e produkteve dhe çështje të secilit departament të CFFA sipas nevojës.

Informacion mbi Kodin e Etikës në Crimson Finance Fund Albania

Crimson Finance Fund Albania ka një Kod Etikë me të cilin të gjithë punonjësit njihen që në momentin e fillimit të marrëdhënies së punësimit. Ky kod trajton çështje si standardet e sjelljes brenda institucionit, përdorimi dhe përhapja e informacionit, konfliktet e interesave, aktivitetet e jashtme dhe të tjera. Disa nga çështjet kryesore janë adresuar si më poshtë:

Konfliktet e Interesave

Stafi duhet të veprojë gjithnjë në interes të Crimson Finance Fund Albania dhe në mbështetje të Misionit të saj. Si të tillë, punonjësit duhet të shmangin konfliktet – apo qoftë

dhe shfaqjen e tyre – ndërmjet interesave dhe përgjegjësive të tyre si pasojë e të qenurit staf i Crimson Finance Fund Albania.

Konflikti i interesit, kur ekziston, mund të rezultojë i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë. Konflikti i interesit gjatë marrëdhënieve të punësimit në Crimson Finance Fund Albania, është konflikti që kërcënon interesin e institucionit nëpërmjet zëvendësimit të tij nga interesi privat. Punonjesit duhet të shmangin çdo rrethanë që krijon konflikt interesash.

Perdorimi dhe perhapja e informacionit

Punonjesit kanë përgjegjësinë të mbrojnë sigurinë e çdo informacioni konfidencial, të siguruar në CFFA apo të prodhuar prej saj. Parimi bazë i rregullave dhe i udhëzimeve lidhur me sigurinë e informacionit është se informacioni i klasifikuar mund të komunikohet tek anëtarët e stafit vetëm në përputhje me aktet rregullative që lidhen me klasifikimin e informacioneve sekrete dhe konfidenciale në Crimson Finance Fund Albania. Nuk lejohet marrja dhe dhënia e informacionit, për përfitime të ndryshme ose kur përbën shkak për lindjen e konfliktit të interesave gjatë marrëdhënieve të punësimit në Crimson Finance Fund Albania.

Aktivitetet e jashtme dhe të tjera





Stafi i CFFA nuk mund të krijojë marrëdhënie të tjera punësimi, të cilat demtojnë apo i bëjnë konkurrencë institucionit, pavarësisht nëse janë aktivitete të shpërblyera financiarisht apo jo, pa miratimin paraprak me shkrim të Drejtorit Ekzekutiv.

Punonjesit e CFFA nuk mund të mbajnë poste politike apo të kryejnë veprimtari me kontribut politik, përveç proceseve demokratike si votimi, etj.

Gjatë marrëdhënieve të punësimit në Crimson Finance Fund Albania, nuk lejohet që punonjesit të kërkojnë ose të pranojnë, drejtpërsëdrejti ose indirekt, dhurata, shpërblime, favore, argëtime, kredi, hua ose çdo gjë tjetër, që ka vlerë monetare, nga persona ose subjekte që:

- a. kanë ose që kërkojnë të sigurojnë përfitime në procedurat administrative, në marrëdhëniet kontraktore ose në çdo marrëdhënie tjetër financiare me Crimson Finance Fund Albania;
- b. kanë interesa që preken në mënyrë thelbësore nga kryerja ose nga moskryerja e detyrave zyrtare të punonjesit të Crimson Finance Fund Albania.

2. Performanca financiare e CFFA



Bilanci kontabel, Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Performanca financiare e CFFA ka qënë vazhdimisht në përmirësim nga një periudhë në tjetrën. Të ardhurat e saj totale janë rritur në mënyrë konstante me rritjen e portofolit të saj, duke arritur në 30.5 milion Lekë në vitin 2019. Gjatë tre viteve të para të aktivitetit, CFFA nuk ka qënë në gjendje të mbulojë kostot operacionale (shpenzimet e interesit dhe shpenzimet e përgjithshme dhe administrative) për shkak të madhësisë së portofolit, por në vitin 2019 institucioni arriti të paraqesë një fitim operacional (duke përjashtuar shpenzimet e zhvlerësimit dhe rezultatin neto të kursit të këmbimit valutor) prej 3.9 milion Lekë. Ndonëse është vërejtur një përmirësim në rezultatin neto që nga viti 2016, CFFA ende nuk ka arritur një fitim deri më 31 Dhjetor 2019. Siç shihet ne tabelen me poshte, humbja neto e saj ka qëndruar konstante midis viteve 2018 dhe 2019 edhe pse EBITDA është përmirësuar. Ky fenomen shpjegohet me faktin se gjatë vitit 2018 CFFA ka gjeneruar një fitim të konsiderueshëm valutor për shkak të zhvlerësimit të euros në krahasim me lekun shqiptar, si dhe disa rregullime për shkak të aplikimit të SNRF 9.

Portofoli i CFFA ka ardhur në rritje nga një vit në tjetrin, duke arritur në 231 milion Lekë në vitin 2019. Sidoqoftë, tendenca në rritje është ngadalësuar gjatë viteve 2018 dhe 2019. Nga ana tjetër, niveli i kredive me probleme është rritur gjithashtu, nga 4.9% në 2017 në 9% në 2018 dhe në 10.9% në dhjetor 2019

Bilanci Kontabel

Crimson Finance Fund Albania

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2019

në Lek

	31 dhjetor 2019	Riparaqitur 31 dhjetor 2018	Ndryshimi	Ne %
	31-Dec-19	31-Dec-18		
AKTIVE				
Aktivet afatgjata				
Aktivet afatgjata materiale	4,455,693	3,279,082	1,176,611	26%
Aktivet afatgjata jomateriale	-	-	-	
Asete me të drejtë përdorimi	1,942,615	-	1,942,615	100%
Totali i aktiveve afatgjata	6,398,308	3,279,082	3,119,226	49%
Aktivet afatshkurtra				
Huadhënie dhe paradhënie (Factoring), neto	133,303,025	128,220,255	5,082,770	4%
Investimi në qera financiare, neto	72,146,471	56,205,206	15,941,265	22%
TVSH e arkëtueshme	15,929,666	11,967,760	3,961,906	25%
Llogari të arkëtueshme të tjera	13,556,848	9,739,791	3,817,057	28%
Tatim fitimi parapaguar	330,000	330,000	-	0%
Mjetet monetare në arkë e në bankë	40,006,522	73,623,181	(33,616,659)	-84%
Totali i aktiveve afatshkurtra	275,272,532	280,086,193	(4,813,661)	-2%
Totali i aktiveve	281,670,840	283,365,275	(1,694,435)	-1%
KAPITALI				
Kapitali themeltar	55,000,000	55,000,000	-	0%
Kapitali nënshkruar i papaguar	(260,240)	(260,240)	-	0%
Humbje të mbartura	(17,130,392)	(14,816,259)	(2,314,133)	14%
Humbja e ushtrimit	(1,886,539)	(2,314,133)	427,594	-23%
Interesa jo-kontrolluese	-	-	-	
Totali i kapitalit	35,722,829	37,609,368	(1,886,539)	-5%
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata				
Hua afatgjata	-	-	-	
Hua afatgjata nga ortakut	-	-	-	
Borxh i varur	238,547,430	241,779,780	(3,232,350)	-1%
Detyrime për qera financiare	-	-	-	
Totali i detyrimeve afatgjata	238,547,430	241,779,780	(3,232,350)	-1%
Detyrime afatshkurtra				
Interesa të pagueshme	1,484,216	2,530,577	(1,046,361)	-70%
Llogari të pagueshme tregtare	477,658	589,151	(111,493)	-23%
Parapagimet e arkëtuara	1,589,320	291,848	1,297,472	82%
Detyrime tatimore	629,012	371,224	257,788	41%
Qera financiare	1,961,401	-	1,961,401	100%
Llogari të pagueshme të tjera	1,258,974	193,327	1,065,647	85%
Totali i detyrimeve afatshkurtra	7,400,581	3,976,127	3,424,454	46%
Totali i detyrimeve	245,948,011	245,755,907	192,104	0%
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	281,670,840	283,365,275	(1,694,435)	-1%

Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve

Crimson Finance Fund Albania

Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe te ardhurave

gjitheperfshirese per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019 ne

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Ndysimi	Ne %
Të ardhura nga interesat	30,336,691	23,856,459	6,480,232	21%
Të ardhura nga interesat factoring	22,766,458	15,565,250	7,201,208	32%
Të ardhura nga interesat leasing	7,570,233	8,291,209	(720,976)	-10%
Shpenzime për interesa	(5,564,630)	(5,523,197)	(41,433)	1%
Të ardhurat neto nga interesat	24,772,061	18,333,262	6,438,799	26%
			-	
Të ardhura të tjera	129,448	182,738	(53,290)	-41%
Fitim/(Humbje) nga këmbimet valutore	919,561	7,919,624	(7,000,063)	-761%
Të ardhurat të tjera operative	1,049,009	8,102,362	(7,053,353)	-672%
Zhvlerësimi neto i qerave financiare, huave dhe paradhënie fa	(3,205,047)	(8,947,650)	5,742,603	-179%
Zhvlerësimi neto i huave dhe paradhënie faktoring	(4,112,660)	(771,579)	(3,341,081)	81%
Zhvlerësimi neto i qerave financiare	907,613	(8,176,071)	9,083,684	1001%
Shpenzime personeli	(13,690,681)	(11,873,360)	(1,817,321)	13%
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	(3,457,962)	(878,933)	(2,579,029)	75%
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	(7,353,919)	(7,049,814)	(304,105)	4%
Total shpenzime	(27,707,609)	(28,749,757)	1,042,148	-4%
Humbja para tatimit	(1,886,539)	(2,314,133)	427,594	-23%
			-	
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	-	-	-	
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	-	-	-	
Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë	-	-	-	
			-	
Humbja e vitit	(1,886,539)	(2,314,133)		0%

Struktura e Kapitalit Rregullator, dhe Mjaftueshmeria e kapitalit.

Me poshte po japim nje table perllorjtese te kapitalit per Crimson Finace Fund Albania me 31 Dhjetor 2019,

Nga tabela e llogarive kapitale, shihet qe kapitali baze eshte me i madh se niveli i kapitalit minimal te kerkuar nga Banka e Shqiperise.

Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto

Crimson Finance Fund Albania

	Kapitali i nënshkruar	Kapitali nënshkruar i papaguar	Humbjet e mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2018	55,000,000	(260,240)	(4,420,566)	(8,361,308)	41,957,886
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2018			(2,034,385)		(2,034,385)
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin të rideklaruar:				(2,314,133)	(2,314,133)
Transferim në humbje të mbartura			(8,361,308)	8,361,308	
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	55,000,000	(260,240)	(14,816,259)	(2,314,133)	37,609,368
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2019					-
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				(1,886,539)	(1,886,539)
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse:					-
Transferim në humbje të mbartura			(2,314,133)	2,314,133	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	55,000,000	(260,240)	(17,130,392)	(1,886,539)	35,722,829

Llogarite Kapitale


Kodi	Llogaritë kapitale (në mijë lekë)	SHUMA MINIMALE	Shuma
1	Subjekte financiare jobanka kredidhënëse	100,000.00	
2	Subjekte financiare jobanka të qirasë financiare; faktoringut; pagesa dhe transfertat; IPE	20,000.00	35,722.829
3	Institucione financiare të mikrokredisë	15,000.00	
4	Subjekte financiare jobanka të shërbimeve këshilluese, ndërmjetëse, e të tjera ndihmëse	10,000.00	

Ekspozimi maksimal i lejueshem

Kodi	EKSPOZIMI MAKSIMAL I LEJUESHËM (në %)	NORMA	Treguesi i llogaritur
2	Totali i ekspozimeve të mëdha / Kapitalit të subjektit	jo me shume se 1200%	343.55


Indikatorët e zhvillimit

668 vende të reja pune të krijuara deri më tani nga financimet tona, 641 vende të reja pune pritet të krijohen deri në Dhjetor 2021 nga klientët tanë



Indikatorët e zhvillimit

580M lekë disbursime për 131 biznese të financuara deri më tani



- Pesë nga sektorët kryesorë ku CFFA operon janë Prodhimi (29%), Tregtia me shumicë dhe pakicë (22%), Transporti dhe Magazinimi (15%), Ndërtimi (12%) dhe Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) (8%).
- CFFA i kushton proporcionalisht **dy herë më shumë** peshë nga portofoli i saj sektorit të Prodhimit krahasuar me tregun, dhe **8 herë më shumë** sektorit të TIK, duke inkurajuar dy prej sektorëve më premtues dhe më të aftë në krijimin e vendeve të reja të punës së kualifikuar.

Portofoli sipas sektorëve	CFFA	TREGU	Diferenca
Prodhimi	29%	16%	+14%
Ndërtimit	12%	15%	-3%
Tregtia me shumicë dhe pakicë	22%	37%	-15%
Transporti dhe Magazinimi	15%	2%	+13%
Teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK)	8%	1%	+7%
Të tjera	14%	30%	-16%

3. Informacion i Përgjithshëm për Ekspozimin ndaj Rreziqeve dhe Administrimin e Tyre

Rreziqet dhe kuadri i administrimit të rreziqeve

Veprimtaritë e Institucionit e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare dhe këto veprimtari përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe administrimin deri në një masë të rreziqeve ose kombinimit të tyre. Marrja përsipër e rrezikut është në qendër të biznesit financiar ndërkohë që rreziqet operacionale janë një rrjedhojë e pashmangshme e të qenit në biznes. Për pasoje, qëllimi i CFFA është arritja e një balance të përshtatshme ndërmjet rrezikut dhe fitimit dhe minimizimi i efekteve të mundshme negative në performancën e Institucionit.

Për këtë qëllim Institucioni ka krijuar një kuader gjithëpërfshirës në mënyrë që të administrojë rrezikun në mënyrë efektive nëpërmjet identifikimit, matjes, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të ngjarjeve potenciale që mund të rezultojnë në humbje apo në zvogëlimin e potencialit të CFFA për të gjeneruar rezultate të qëndrueshme.

Mbrojtja e parë e Institucionit kundër humbjeve është e reflektuar në kontrollet dhe modelin e brendshëm sipas të cilit Institucioni operon. Institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e të gjithë rreziqeve me të cilat ballafaqohet. Në këtë kontekst, të gjithë proceset e biznesit janë dizenuar që të reduktojnë impaktet e mundshme nga rreziqet, duke respektuar “oreksin” e Institucionit kundrejt rrezikut dhe nivelet e percaktuara të tolerances ndaj tij. Cdo punonjës dhe veçanërisht “përgjegjësit” e proceseve, mbajnë përgjegjësi primare për administrimin e rreziqeve dhe për rrjedhojë mirëmbajtja e kontrolleve të nevojshme dhe e vigjilencës në nivelin e duhur, është pjesë rutinore e punës së tyre.

Duke konsideruar profilin e rrezikut dhe karakteristikat e tij, rreziqet me të cilët përballet Institucioni janë:

Rreziku i Kredisë, Rreziku i Likuiditetit, Rreziku i Normave të Interesit, Rreziku i Kundërpartisë, Rreziku i Kurseve të Këmbimit dhe Rreziku Operacional. Politikat e CFFA lidhur me administrimin e rrezikut janë hartuar në mënyrë që të identifikojnë dhe analizojnë këto rreziqe, të vendosin kontrole dhe limite të përshtatshme dhe kontrole të rrezikut, si dhe të monitorojnë rreziqet dhe përjasjen e tyre ndaj limiteve me anë të sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit.

Politikat kryesore të administrimit të rreziqeve

Politika e Administrimit të Rrezikut

Politika përcakton rreziqet kryesore ndaj të cilave është i ekspozuar Institucioni, si dhe parimet kryesore dhe kuadrin e përgjithshëm të administrimit të rrezikut sipas kategorive të rreziqeve të indentifikuara dhe të aplikueshme për Institucionin.

Politika e Kredisë

Politika e Kredisë është dokumenti primar cili përcakton parimet e administrimit të rrezikut të kredisë.

Rreziku i kredisë mund të ulet ose pakësohet me kredidhënie të orientuar ndaj fluksit të parave, kolateral të mjaftueshem si mbrojtje e nivelit të dytë, vendosje e përshtatshme e çmimeve bazuar në rrezikun optimal, strukturim efektiv dhe diversifikim të portofolit, kontrole të nevojshme e gjithëpërfshirëse të Institucionit, etj. Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi është edhe monitorimi i vazhdueshëm e i nevojshëm i fondeve rezervë për mbulimin e rrezikut (provigjioneve).

Rreziku i kredisë

Struktura e administrimit të rrezikut të kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku që pala tjetër e një instrumenti financiar të dështojë në ripagimin e detyrimit dhe t'i shkaktojë Institucionit humbje. Institucioni është subjekt i rrezikut të kredisë nëpërmjet veprimtarisë së tij kredituese, dhe në rastet kur ajo vepron si ndërmjetëse në emër të klientëve ose palëve të treta kur lëshon garanci, në këtë rast, rreziku i kredisë buron nga mundësia që palë të ndryshme të mund të deshtojnë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale.

Bazuar në politikat e aprovuara nga Bordi Drejtues, Komiteti i Kredisë të Institucionit është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të kredisë. Përveç kësaj Departamenti i Kredisë në Institucionin i raporton Drejtorit Ekzekutiv të CFFA, dhe është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të kredisë, duke përfshirë:

- Hartimin e politikave të kredisë në konsultim me njësitë e biznesit, duke përfshirë kerkesat e mbulimit të kolateralit, vlerësimin e kredisë, raportimin dhe nivelet e rrezikut, procedurat e dokumentimit dhe ato ligjore, si dhe përputhshmërinë me kerkesat rregullatore dhe statutore.
- Vendosjen e strukturave të autorizimit për aprovimin dhe rinovimin e kreditimit. Aprovimi dhe rinovimi i kreditimit kërkojnë aprovim nga Departamenti i Kredisë, Drejtuesi i departamentit të Kredisë, Komiteti i Kredisë të Institucionit ose Bordi Drejtues, sipas niveleve të përcaktuara.
- Rishikimin dhe vlerësimin e rrezikut të kredisë. Departamenti i kredisë në Institucion vlereson të gjithë ekspozimet e kreditit që tejkalojnë limitet e përcaktuara, përpara angazhimit për kreditim ndaj paleve të përfshira. Rinovimet dhe rishikimet e limiteve janë subjekte të të njëjtit proces rishikimi.
- Kufizimin e përqendrimit të ekspozimit ndaj kundërpartive, vendodhjes gjeografike dhe llojit të industrisë (për kredi dhe paradhenie).
- Zhvillimi dhe mbajtja e niveleve të rrezikut në Institucion me qëllim kategorizimin e ekspozimeve sipas shkallëve të humbjes financiare të ndodhur dhe për t'i tërhequr vëmendjen drejtimit drejt rreziqeve të tjera. Sistemi i niveleve të rrezikut është përdorur në përcaktimin nëse provigjione për zhvlerësimin mund të kërkohej ndaj ekspozimeve specifike të kredisë. Struktura aktuale e niveleve të rrezikut konsiston në dhjetë nivele duke reflektuar nivele të ndryshme të rrezikut të mospagesës dhe vlefshmerisë së kolateralit ose zbutës të tjerë të këtij rreziku. Përgjegjësia e përcaktimit të niveleve të rrezikut shkon me aprovimin final të ekzekutivit/komitetit, sipas përcaktimeve. Nivelet e rrezikut janë subjekt i rishikimeve të rregullta nga Drejtimi Ekzekutiv i Institucionit.
- Rishikimi i përputhjes së njësisë së biznesit me limitet e ekspozimit të rëna dakord. Raporte të rregullta /periodike mbi cilësinë e kredisë u jepen Departamentit të Kredisë në Institucion, në mënyrë që të marrin masa veprimi më pas.
- Dhënia e këshillave, udhëzimeve dhe aftësive teknike njësisë të biznesit, për të përhapur praktiken më të mirë në Institucion në lidhje me administrimin e rrezikut të kredisë.

Kategorizimi i kredive në kuadër të rrezikut të kredisë

Institucioni ka krijuar procedurat përkatëse për administrimin e rrezikut të kredisë, përshtatur kjo me vëllimin, kompleksitetin e veprimtarisë së tij, por gjithmonë duke u bazuar në rregulloren nr. 62 të Bankes së Shqipërisë "Për Administrimin e rrezikut të kredisë". Mbështetur në këtë rregullore, Institucioni klasifikon kreditë në bazë të ditëvonesave në shlyerjen e kredisë dhe gjendjes financiare të kredimarrësit sipas kategorive të mëposhtme:

- a) standarte;
- b) në ndjekje;
- c) nënstandarte;
- d) të dyshimta;
- e) të humbura

Institucioni për persona apo grup personash të lidhur me njeri tjetrin, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin me të ulet ndërmjet klasifikimeve individuale.

Portofoli kreditor, kreditë me probleme dhe krijimi i fondeve rezervë

Kreditë konsiderohen me probleme kur janë të klasifikuara në një nga tre klasat e fundit të kategorive të mësipërme. Në varësi të kategorive të mësipërme, Institucioni krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë. Fondet krijohen në përputhje me rregulloren për "Administrimin e rrezikut të kredisë", duke aplikuar normat e provigjonimit të çdo kategorie në të cilën kredia/klienti bën pjesë, si mbi principalin e mbetur dhe mbi interesin e rrjedhur për këto kredi. Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë administrohet gjithashtu pjesërisht nga marrja e kolateraleve dhe garancive. Llojet kryesore të kolateraleve janë:

- Prona hipotekore ose rezidenciale
- Makina dhe kamion
- Pajisje dhe makineri

Rreziku i tregut

Institucioni ekspozohet ndaj rreziqeve të tregut sa herë që vlera e tregut ose flukset e ardhme të parasë luhaten si pasojë e ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziqet e tregut burojnë nga pozicione të hapura të bilancit në norma të interesit dhe monedhës, të cilat të gjitha ekspozohen ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe të veçanta të tregut, dhe ndryshimeve në nivelin e volatilitetit të normave të tregut ose çmimeve si norma e interesit, marzhetit të kredisë, dhe kurset e këmbimit të valutave.

Rreziku i monedhës së huaj

Institucioni është i ekspozuar ndaj rrezikut të monedhës nëpërmjet transaksioneve në valuta të huaja. Rreziku i monedhës së huaj është rreziku sipas të cilit vlera e instrumentit financiar të luhatet si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit në treg. Institucioni përpaket ta administrojë rrisun duke mbyllur pozicionet e hapura valutore ditore dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi pozicionet e hapura. Monedha e paraqitjes së pasqyrave financiare të CFFA është Lekë, në këtë mënyrë ato janë të ndikuara nga lëvizjet në kurset e këmbimit valutator midis monedhës Lekë dhe monedhës së tjera të huaja. Ekspozimet e transaksioneve të Institucionit çojnë në humbje ose fitime nga valutat e huaja që njihen në pasqyrën e performancës. Departamenti i thesarit është përgjegjës kryesor për ndjekjen dhe monitorimin mbi baza ditore të këtij rreziku, sidomos lidhur me ruajtjen me fanatizëm të limiteve të vendosura në Politikën përkatëse. Raportimi lidhur me kryhet çdo ditë tek Drejtori i Financës dhe Departamenti i Menaxhimit të Riskut, i cili bën monitorimin e limiteve po mbi baza ditore.

Rreziku i normes së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e instrumentave financiare do të ndryshojë si pasojë e ndryshimeve në normat e interesit të tregut të aplikueshme për këto instrumenta financiare. Rreziku i ndryshimit të rrjedhjes së parasë nga ndryshimi i normës së interesit është rreziku që shpenzimet e interesit do të ndryshojnë gjatë periudhës.

Rreziku operacional

Rreziku Operacional është i pranishëm përgjatë lëvrimin të të gjitha produkteve dhe shërbimeve financiare dhe mund të shfaqet në transaksionet që procesohen. Ai mund të ndodhë edhe si rezultat i sistemeve të pamjaftueshme të informacionit të papërshtatshëm, dështimeve të teknologjise, dëmtimit të kontrolleve të brendshme, mashtrimeve apo katastrofave të paparashikueshme.

Në mënyrë që të mbrohet nga rreziku operacional Institucioni ka hartuar një kuader të brendshëm, i cili përfshin përkufizime të qarta të rrezikut operacional, strukturën përkatëse, instrumentat e përdorur si dhe filozofinë e vetë-vleresimit të proceseve nga ana e CFFA. Gjithashtu ka zhvilluar një set treguesish kyç të rrezikut dhe është duke monitoruar në mënyrë aktive performancën e tyre.

Stafi përgjegjes i Riskut Operacional i Institucionit ndjek në menyrë periodike ngjarjet që shkaktojnë humbje operationale dhe ka përcaktuar përgjegjësitë përkatëse për shmangien e humbjeve si dhe përshtatshmërinë e procedurave, efijencën e kontrolleve dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë.

Menaxhimi i Riskut dhe Kontrolli i Brendshëm

Menaxhimi i Riskut dhe Kontrolli i Brendshëm, bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën për identifikimin nëpërmjet kontrollit të risqeve të mundshme duke u përqendruar në çështjet kryesore si më poshtë:

- 1. Risqet e njësisë që kontrollohet**
- 2. Risqet e fushave të kontrollit**
- 3. Kontrollet e brendshme që zvoglojnë riskun**

Risqet e njësisë që kontrollohen

Puna paraprake mbi kuptimin e njësisë dhe veprimtarinë e saj duhet që normalisht të jetë e mjaftueshme për të identifikuar riskun në nivel njesise. Është e pamundur të përgatitet një listë e gjatë me faktorët e riskut, por për shumicën e rasteve faktorët e mëposhtëm janë të rëndësishëm për Menaxhimin e Riskut dhe Kontrollin:

- a) **Mjedisi i përgjithshëm i kontrollit:** në veçanti angazhimi i stafit ndaj kontrollit të brendshëm financiar dhe raportimit të saktë financiar;
- b) **Presioni i vazhdueshëm mbi njesinë:** aty ku njesia ndodhet nën një presion të madh nga jashtë nga ana e aksionereve për të arritur rezultate të veçanta, risku do të jetë përgjithësisht më i lartë sesa në ato raste ku ka më pak interesim të jashtëm ndaj CFFA;
- c) **Eksperienca dhe përvoja e stafit:** risku është normalisht më i ulët aty ku stafi ka përvojë, ka trajnimin e duhur dhe është i mirë mbikëqyrur.
- d) Qarkullimi i lartë, mungesë angazhimi për trajnime dhe mbikëqyrje e dobët janë faktorë që do të çonin në një nivel më të lartë të riskut;
- e) **Besueshmëria e sistemeve kontabël:** transaksione të përpunuara sistematikisht nëpërmjet sistemeve të provuar dhe të testuar normalisht rezultojnë në risk më të ulët. Sistemet e reja, sistemet që kërkojnë një nivel të caktuar të punës manuale ose ato sisteme që janë shtuar ose zgjeruar në
- f) një farë mënyre, priren të kenë më shumë risk;
- g) **Qëndrueshmëria e subjektit:** Në baze të experiences se një prej aksionereve I cili drejton institucione që kryejnë të njëjtat funksione në të njëjtën mënyrë për vite me radhë priret drejt një risku të ulët. Ndryshimet e mëdha nëpërmjet shtimit ose zhvendosjes së funksioneve dhe kufizimeve organizative ose gjeografike priren të rrisin nivelin e riskut.

Menaxhimi i Riskut dhe Kontrolli duhet gjithmonë të jete në gjendje të lidhe risqet e identifikuar në nivel institucioni me fushat specifike të llogarisë dhe objektivat e kontrollit.

Për shembull, nëse stafi është nën presion për të arritur objektiva të veçanta të performancës, faktorët specifikë të riskut mund të jenë të pranishëm në ato fusha llogarie të cilat janë të rëndësishme për këto objektiva dhe konsiderohen të jenë të ndjeshme ndaj manipulimeve.

Menaxhimi i riskut analizon, për secilën kategori të riskut të institucionit, rrethanat e ndryshme sipas të cilave këto risqe mund të klasifikohen si të larta apo normale (të ulëta nëmesatare). Kontrolli, duke u mbështetur në kuptimin dhe njohjen e tyre për institucionin, duhet që me pas të përpiqet të identifikojë risqet “e larta” të cilat mund të çojnë në parregullsi materiale në llogarite që ai do kontrollojë.

Kontrollet e brendshëm që zvogëlojnë riskun

Aty ku menaxhimi i riskut ka identifikuar faktorët specifikë të riskut, kontrolli do të ndermarre ato kontrole që me efektivitet zvogëlojnë këto faktorë të riskut.

Proçedurat e kontrollit janë politikat dhe rregullat që drejtimi vendos për t’u mbrojtur nga mashtrimet, humbjet, parregullsite dhe deklaratat e rreme. Ato mund të jenë të një natyre parandaluese ose investigative/gjurmuese. Ekzistojnë një sërë mënyrash të ndryshme për të klasifikuar proçedurat e kontrollit, por për qëllimet e kontrollit ato përmbledhen si me poshte:

- **Kontrollet e manaxhimit/drejtimit:** ato përfshijnë nivelin e lartë të mbikëqyrjes dhe rishikimit nga ana e manaxhimit/drejtimit. Ato janë përgjithësisht të një natyre investigative dhe përfshijnë, për shembull, rishikimin nga manaxhimi i raporteve përjashtuese (rasteve të veçanta), performancës kundrejt buxheteve/planeve dhe përdorimit të ekspertëve profesionale.

- **Kontrollet organizative:** Këto kontrolle rrjedhin nga mënyra sipas se cilës subjekti është strukturuar dhe ato mund të jenë si investigative ashtu dhe parandaluese. Ato mund të përfshijnë normalisht përcaktimin e duhur të përgjegjësive dhe ndarjen e funksioneve të papajtueshme siç janë inicim I transaksioneve, përpunimin dhe regjistrimin e tyre.
- **Kontrollet e autorizimit:** Këto normalisht veprojnë në nivel individual të transaksioneve dhe janë të një natyre parandaluese. Qëllimi i tyre është të ndalojnë përpunimin e një transaksioni nëse nuk është miratuar nga autoriteti përkatës. Kontrollet e mira të autorizimit do të jenë specifike për atë që duhet të japë miratimin dhe për çfarë, masën e verifikimit të kërkuar para se të behet miratimi dhe mënyra se si ky verifikim duhet të evidentohet.
- **Kontrollet e funksioneve:** Këto kanë të bëjnë me plotësinë dhe saktësinë e përpunimit dhe ndoshta mund të jenë si investigative ashtu dhe parandaluese. Ato mund të përfshijnë: verifikimin e njëpasnjëshëm për të krijuar siguri mbi plotësinë e dokumenteve të numëruara; krahasimi i një grup dokumentesh me një grup tjetër (shembull: urdhërpagesat/çeqet me kontratat/komisionet per garanci me % perkatese, etj.); dhe përdorimin e shumave totale të kontrollit dhe rakordimeve.
- **Kontrollet fizike:** Këto janë projektuar zakonisht për të qenë parandaluese dhe përfshijnë kontrollet mbi ekzistencën e asetëve dhe regjistrimeve kontabël nëpërmjet masave të thjeshta fizike të tilla si transferimi dhe ruajtja, por edhe kontrolle logjike të tilla si akses fjalëkalimi për dosjet kompjuterikë.